

ALBERT THOMA



Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Ka lindur në vitin 1963. Diplomuar në Inxhinieri Mekanike (1985) dhe në Ekonomi, dega Plan (1992).

Ka 29 vjet eksperiencë pune. 6 vitet e fundit në KLSH.

Kryeauditues nga muajit janar 2011.

Fusha e ekspertizës: Menaxhim bankar.

PARTNERITETI NË MISIONET AUDITUESEⁱ

Albert Thoma

Sigurimi i kontrollit të operacioneve është një prioritet që organizatat e ndryshme e kanë në qendër të vëmendjes në strategjitë që zgjedhin të ndjekin për të mbrojtur aktivitetet dhe maksimizuar fitimet. Për këtë qëllim shpenzohen jo pak, vecanërisht për auditimin e jashtëm, duke pajtuar shoqëritë e konfirmuara në treg për sigurinë që japin nga auditimi që kryejnë në organizatat e ndryshme. Tashmë kjo është bërë jo thjesht një normë në biznes dhe në aktivitete të ndryshme të organizatave por një domosdoshmëri sidomos në organizata ku burimet njerëzore zënë një pjesë të konsiderueshme në kapitalin e tyre, si bankat, operatorët telefonik, operatorët e prodhimit më shtrirje në treg dhe hapësirë, ata që operojnë në fushën e ndërtimit, ushqimit, shërbimet etj. Po pse të shpenzohen për auditim të jashtëm ndërkohë që mund të mbulohet nga auditimi i brendshëm? Eksperienca ka vërtetuar që sigurinë optimal për konkluzione të sakta mund

ta sigurojë vetëm një auditim i pavarur pasi faktorët që ndikojnë në këtë drejtim, si jashtë dhe brenda organizatës, janë kompleks. A mjafton vetëm nevoja për siguri optimale në konkluzionet e auditimit e diktuar nga faktorë të ndryshëm? Në kushtet kur biznesi tenton të performojë gjithmonë e më mirë në treg, të sigurojë qëndrueshmëri dhe të maksimizojë vlerën e kapitalit, rruga më efikase është harmonizimi i auditimit nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Ky proces jep rezultate maksimale kur fryma e menaxhmentit bazohet mbi partneritetin me subjektet e jashtëme të auditimit, për të dy palët, subjektin që auditon dhe subjektin që auditohet. Kjo arrihet kur subjekti që auditohet kupton plotësisht përfitueshmëria nga auditimi. Ndërkohë që në sektorin privat dobia është lehtësisht e kuptueshme sa që investohet për këtë qëllim në sektorin publik nuk është në nivelin e kërkesave të kohës. Drejtuesit e institucioneve publike në shumë raste priret nga antagonizmi në marrëdhëniet me auditimin e jashtëm, KLSH, ndërkohë që e kundërta ndodh në politikat që ndjek KLSH sidomos dy vitet e fundit. Por a është i njëjtë qëllimi i auditimit të jashtëm për të dy palët?

Në bazë të ligjit nr. ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, neni 2, qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike nga njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë. Në bazë të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 për Kontrollin e Lartë të Shtetit, neni 6, objekti kryesor i punës së këtij institucioni është kontrolli i përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimi i mirëadministrimit financiar dhe kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare. Sic shihet qëllimi është i njëjtë dhe përpjekjet duhet të bashkërendohen për arritjen e këtij qëllimi.

KLSH ka zgjeruar dimensionet e veprimtarisë së tij si dhe ka rritur në maksimum transparencën me njësitë e sektorit publik, median dhe publikun në tërësi, sidomos kohët e fundit, ndër të tjera dhe për të informuar publikun dhe veçanërisht njësitë e sektorit publik, mbi përfitueshmërinë që sjell veprimtaria audituese e KLSH.

Në këto kushte KLSH në misionet e auditimit, përtej përcaktimeve dhe detyrimeve ligjore, ka tentuar që subjektin që auditohet ta konsiderojë më shumë partner në arritjen e qëllimeve të përbashkëta duke forcuar frymën e bashkëpunimit në proceset audituese. Nga ana tjetër njësitë e sektorit publik, që janë object I auditimit të KLSH, nuk priren në shkallën e duhur dhe në të njëjtin nivel me KLSH përsa I përket partneritetit dhe bashkëpunimi jo gjithmonë ka qenë efektiv nga ana e tyre. Kjo ndodh dhe për një fakt tjetër domethënës. KLSH në strategjinë afatmesme dhe në politikat që ndjek për arritjen e misionit, bazuar dhe në prioritet e stabilizim-asocimit me BE, ka forcuar luftën kundër korrupsionit dhe e ka vendosur një prioritet bazë në strategjinë afatmesme e cila nuk konvergjon me përpjekjet që bëhen nga subjektet e audituara dhe kjo i bën ato të priren nga fryma anatagoniste në marrëdhënie me proceset audituese të ushtruara nga KLSH. Bazë në frymën e kësaj marrëdhënieje janë standardet ndërkombëtare në fushën e auditimit, zbatimi I të cilave me korrektësi nga KLSH, I jep më shumë shtysë menaxhmentit të njësive të sektorit publik për të kuptuar përfitueshmërinë nga konkluzionet dhe rekomandimet e KLSH dhe për të dhënë kontribut specific duke u udhëhequr nga fryma e partneritetit në marrëdhënie me KLSH për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 25 qershor 2013